

VENDIM
Nr. 490, datë 10.7.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 82, DATË 14.2.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E AGJENCISË SË BLERJEVE TË
PËRQENDRUARA PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE
DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 2, të tekstit “Rregullat e prokurimit publik”, bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Përfshihen nga zbatimi i këtij vendimi përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, për nevojat e tyre, si dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera shtetërore të atashuar pranë tyre. Për këto kategori, procedurat për blerje automjetesh realizohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara jashtë vendit, sipas rregullave të tyre të brendshme.”.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama